



Adresa: L. "Kastriot"; Rruga "Ramiz Aranitasi"; Nr.15 Fier - SHQIPËRI Tel. + 355 34 410 650 website: bashkiafier.gov.al

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: RIKONSTRUKSION I SEGMENTIT TE RRUGES QENDER DARZEZES - PLAZH (NE LINDJE E PERNDIM), FIER

TE PERGJITHESHME

Ne zbatim te Projekt detyres eshte kerkuar hartimi I projektit te zbatimit per Rikonstruksionin e rruges nga Qendera e Darzezës deri Plazh, ne Lindje te hidrovorit dhe ne perndim te tij .Segmenti ne Lindje do te jete me nje gjatesi pre 1265 ml dhe me nje gjersi 6 metra me bankina ne te dy krahet dhe me nje kanal kullues nga njeri krah, kurse Segmenti ne perndim te Hidrovorit do nte kete nje gjatesi prej 760 ml dhe nje gjersi 6m me bankina ne te dy krahet . Ket dy segmente rruge shtrihen ne pjesen Jugore te fshatit Darzezë te Njesise administrative Dermenas , Fier dhe ben lidhjen me Fierin dhe te gjitha fshatrave qe ndodhen ne rrugen Seman Fier me plazhin e Darzezës. Drejtoria e projektimit prane Bashkise Fier hartoi kete material per kete projekt zbatimimi :

1. Pershkrimi I gjendjes aktuale
2. Masat qe do te merren per rikonstruksionin e dy segmenteve te rruges .
3. Masat inxhinjerieke .
4. Vizatimet me hollesite e domosdoshme.

1.PERSHKRIMI I PROJEKTIT:

GJENDJA DHE MASAT QE DO MERRIN PER RIKONSTRUKSIONIN: *Rikonstruksioni I Segmenteve Rrugore - Qender Darzezë – Plazht ne Lindje dhe ne perndim te Hidrovorit , eshte hartuar ne baze te projekt detyres se miratuar .*

Ne zbatim te projekt-detyres eshte bere realizimi i projektit, ku ne te jane pasqyruar hollesisht te tere elementet e domosdoshem per rikonstruksionin e saj. Rikonstruksioni i segmentit rruges ne Lindje ,perfshin segmentin rrugor i cili fillon ke ura e Hidrovorit ne qender te fshatit Darzeze dhe perfundon ne një segmente me gjatesi prej 1265 m ,kurse segmenti perndimor Fillon nga qendra e fshatit Darzeze ne pikat fikse qe do te jepen ne projekte dhe perfundon ne bregdet por nuk kalon hidrovorin dhe ka nje gjatesi prej 760ml.

Pervet rikonstruksionit te ketyre dy segmenteve te rrugore ekzistuse eshte parashikuar dhe zgjerimi i tyre me nje meter duke i kthyer keto rruge me gjersi 5m (jashte Standartit), ne rruge me gjersi standarte 6m,duke u bere zgjerimin ne njerin krahe me 1 (nje) meter . Keshtu nga piketa Nr.4 deri ne piketen Nr.58 segmenti lindor dhe nga piketa Nr.01 deri ne piketen Nr.39 neselementin prndimore do te behet zgjerimi prej 1m .

Gjendja konkrete e te dy segmenteve eshte shume e keqe .Keto segmente jane bere para viteve 209-2010 me rer bituminoze 3-6 cm mbi nje shtres stabilizanti 10 cm .Te dy segmente jane te hamortizuara ,te gropezuara me nje nivelet te deformuar gjate gjithë gjatesise e gjersive .Kalimi i automjeteve me nje tonash te vogel te cilat duhet te kalojne per ne Plazhin e darzezes gjate sezionit te plazhit pothuajse behe e pakalushme dhe aksidentale.

Ne realizimin e rikonstruksionit dhe zgjerimit te ketyre dy segmenteve te pershkruar me larte , eshte parashikuar te behet zgjerimi duke u germuar nga te njeri krahe ne nje thellesi prej 50 cm , me nje gjersi 1m dhe me nje gjatesi prej 1125 ml ne segmentin Lindor sipas piketave te larte permndura, dhe gjate gjithë gjatesise te segmentit Perendimor .Germimi prej 1 meter ne gjersi ne te dy segmente,eshte parashikuar ndertimmi i kasonetes dhe mbas gjeshjes de kontrollit te tabanit , per te dy segmentet do te filloi mbushja e shtresave te parashikuara hollesishte ne profilin tip ne projektin e realizuar per kete qellim.

Per realizimin e ketij projekti do te jete e nevojshme skarifikimi i rruges ekzistuse ne nje thellesi jo me shume se 2 cm (Zbankimi i reres bituminoze) .

Ne te gjithë zgjerimin e realizuar ne te dy segmentet mbasi eshte bere hedhja e gjeshja e stabilizantit me rul sipas kushteve teknike te zbatimit do te hidhet shtresa e binderit prej 5(pese)cm dhe po keshtu pastaj gjate gjithë gjersise se rruges do te hidhet shtresa e asfalto betonit me t=3 cm me nje pjerreia terthore 2.5% duke filluar nga aksi dhe se fundmi ndertimi i bankinave me cakull me nje pjerresi 8% -10%.

Shtresat e parashikuara ne rikohstruksionin dhe zgherimin e rruges do te jene sipas profileve tip te dhena ne flete te vecanta te projektit dhe konkretishte do te jene :

- 1.Shtres cakulli minash 0-100 mm t=20 cm(Ne zgjerim)
- 2.Shtres cakulli 0- 80. mm t=15 cm
- 3.Shtres stabilizanti (0-40)mm..... t=10 cm

Shtresat asfaltike gjate gjithë gjersise se rruges jane parashikuar dhe paraqitur sipas prerjes terthore tip si me poshte :

- 1.Shtres binderi 5 cm
- 2.Shtres asfalto betoni 1x3 cm .

Bankinat anesore jane parashikuar te behen me shtre çakull minash me t=15 cm me gjeresi 50 cm ne te dy krahet .

Rikonstruksioni i rruges eshte parashikuar me pjerresi te dy aneshme 2.5 % sipas profilit tip te paraqitur ne projekt .

Aksi i rruges do te jete ndarja ne mese me gjithë gjersine e zgjerimit te bere ne te dy segmentet ne lidje dhe perndim.azhdim i aksit te rruges ekzistuse ne qender te saj.

KANALIZIMET

Ne projekt eshte parashikuar qe ne njerin krahe te behet nje kanal per largimin e ujrave te shiut dhe ndertimi i nje tombinoje Φ 600 mm ne piketen nr.49 per derdhjen e tyre ne krahun tjeter te rruges drejt kanalit te hidrovorit.Ndertimi dhe largimi i ujrave te bardha nga piketa Nr.4 deri ne pik.Nr.58 duke bere nje kanal anesor ne lindje te saj me dimesione 120 larte 60 cm poshte dhe ne thellesine 80 cm .Tombinua eshte parashikuar te behet sipas hollesise te dhene ne projekte dhe me mbrojtje ansore ne te dy krahët.

SINJALISTIKA

Ne projektper te dy segmente eshte parashikua dhe ndertimi i sinjalistikes horizontale dhe vertikale .Ne sinjalistiken horizontale jane parashikuar vijat e vazhduara ansore me boj te barshe ne te dy krahët e saj me gjersi 15cm kurse ne aksin e rruges me nje vije te nderprere qe lejon parakalimin e mjeteve me gjersi 15 cm ne vende te vecanta dhe jo gjate gjithë gjatesise,kurse ne afesrsi te ures ku eshte parashikuar ndertimi i vijave te bardha per kalimin e kemsoreve nga njeri krahe ne tjetere .Jane parashikur vendosja e te gjitha tabelave duke filluar nga shpejtesia e mjeteve e deri ke ndalimi per kalimin e njerezve .Te gjitha sipas Kushteve teknike te zbatimit.Te gjitha punimet jane paraqitur ne preventivin qe shoqeron projektin , pervec hollesive te lart permendura eshte parashikuar te behet edhe ndertimi i sinjalistikes , vendosja e tabelave , te drejten e kalimeve , vijezimet si per kembesore ashtu edhe per mjete . Ne realizimin e sinjalistikes horizontale duhet te keni parasysh perdorimin e bojës Fosforishente e aplikuar me dimesione: per vijezim kalimtaresh 0.5 x 3 m me hapsira boshe 0.2 m ,per vijezim makinash dhe karexhate me dimesione 0.15m gjeresi. Para kthesave 6m vendoset viza ndaluese paralajmruese.

Ne realizimin e sinjalistikes vertikale ne projekt jane parashikuar tabelat me diameter 0.6 m dhe lartesi 2.5 m brenda standarteve qe parashikon kodi rrugor (fosforishente).Inkastrimi i tabelave (tubos) do te behet me beton dhe jo me pak se 50 cm ku tubua do te jete xingato me diameter Φ 60 mm.Gjate gjithë gjatesise ne te dy segmentet eshte parashikuar edhe endosja e pervijusave normale cdo 50metra ne te dy krahët.

Rruga eshte parashikuar me materiale standarte sipas KTZ.

3 MASAT INXHINJERIKE

Duke qene se Rikonstruksioni dhe zgjerimi i segmenteve rrugore nga ura e Hidrovorit Qender Darzezës deri ne plazh (Ne Lindje dhe ne perndim) te tije , ku ben lidhjen e te gjithë fshatrave me qytetin e Fierit dhe te Komunes

Seman ,Qendertj. Per kete qellim gjersia aktuale e segmenteve te rruges eshte bere sipas standarteve te projektimit me dy korsi nga 3m sejcila . Nepermjet pjerresise terthore prej 2.5 % eshte bere e mundur largimi i ujrave te shiut te cilat nepermjet kanalit ansore te ndertuar i ri ne perndim te saj dhe ne ate ekzistues ne lindje ben te mundur largimin e tyre . Per zbatimin e ndertimit te rruges ne vende te vecanta jane lene pika fikse si per aksin e rruges ashtu edhe per kueten e projektit ,vecanrishte ne lidhjen e rruges qe po bejme me rrugen egzistuese(uren) , ku bashkimi i saj dote behet duke bere prerje me sharre dhe me ne zbutje shume te embel.

Fillimi i rruges do te behet sipas percaktimit ne planimetri te pikave dhe kuotave fikse .Eshte parashikuar qe ne te dy urat e hidrovorit dhe ne uren ekzistuse te krahut perndimor si dhe te tombinos te krahut Lindore ,ne te dy krahet do te vendose guardril H2 anesore, per sigurimin e komunitetit ose pushuesve.

REKOMANDIME

Duke respektuar nderhyrjet per themelin e rruges ,permirsimet e elementeve gjeometrik dhe tegjitha punimet qe do te kryhen per rikonstrukcionin e segmenteve te rruges Organizimi i pune mendojme te behet ne kete menyre :
1.Ndertimin e kanalizimeve te ujrave te bardha dhe ne vazhdim ne zgjrimin e e te njerit krah deri ne shtresen e stabilizantit pastaj anen tjetër po ne lartesine e stabilizantit .Me perfundin e zgjerimeve ne te dy segmentet do te behet hedhja e binderit ne njerin krahe duke bere bllokimin e krahut tjetër dhe pastaj ne menyre reciproke ,kurse mbas perfundimit te krahut te pare behet krahu i dyte dhe pastaj asfaltimi i te gjithë gjersise se rruges ku eshte bere paraprakishte skarifikimi i rruges ekzistuese dhe pastrimi i saj .Mundet qe te behet dhe bllokimi i kalimeve ne segmentin lindor dhe anasjelltas sipas organizimit te punimeve .

Asfaltimi do te behet mbrenda standarteve dhe cilesise se materialir dhe KTZ.

TE DHENA TEKNIKE

A. PUNIME RRUGORE

1. GERMIM DHEU KASONET ME MAKINERI

Ky ze pune eshte parashikuar ne zgjerimin e rruges dhe te kryhet me makineri dhe te ngarkohet ne AUTO . hidht ne vendet e percaktuara me pare nga investori .

Pjesa fundore nivelohet e profiloher ,si dhe rulohet me rul.

Matet ne m³.

2. SKARIFIKIMI NE RRUGE I ASFALTO BETONIT

Skarifikimi i shtreses se asfaltobetonit 1-2 cm ekzistuse ne rruge eshte parashikur te kryhet me makineri .Matja do te behet ne m2.

3. SHITRESE CAKULL MINASH 0-100 dhe 0-80 mm.

Ky material do te perbehet nga cakull minash gur I thyer dhe I perzier ne granulometrine e duhur , shtresa do te behet t=20 cm .Ngjeshja do te behet me rula vibrues duke e lagur me uje dhe do te jete 95%.Ne analize parashikohet blerja , transporti , perhapja dhe ngjeshja e shtreses .Matja do te jete ne m².

Materialet e perdorura per shtresen baze te perbere prej gureve te thermuar do te merren nga burimet e caktuara gurore , duhet te jene te forte me durueshmeri te mire. Nuk duhet te permbaje pjese shkembinjesh te dekompozuar ose material argjilor.

4.SHTRESE MATERIAL I THYER 0-80mm.

Ky material do te perbehet nga cakull frantoreje gur I thyer dhe I perzier ne granulometrine e duhur , shtresa do te behet 1 x 15 cm .Ngjeshja do te behet me rula vibrues duke e lagur me uje dhe do te jete 95%.Ne analize parashikohet blerja , transporti , perhapja dhe ngjeshja e shtreses .Matja do te jete ne m².

Materialet e perdorura per shtresen e lartpermendur jane te perbera prej gureve te thermuar , do te merren nga burimet e caktuara gurore ,duhet te jene te forta dhe me durueshmeri te mire.Nuk duhet te permbaje pjese shkembinjesh te dekompozuar ose material argjilor.

5.SHTRESE MATERIAL I THYER 0-40 mm.(stabilizant)

Ky material do te perbehet nga cakull frantoreje gur I thyer dhe I perzier ne granulometrine e duhur , shtresa do te behet 1x 10 cm .Ngjeshja do te behet me rula vibrues duke e lagur me uje. Ne analize parashikohet blerja transporti ,perhapja dhe ngjeshja e shtreses .Matja do te jete ne m².

Materialet e perdorura per shtresen e lartpermendur jane te perbera prej gureve te thermuar do te merren nga burimet e caktuara gurore ,duhet te jene te forta dhe me durueshmeri te mire.Nuk duhet te permbaje pjese shkembinjesh te dekompozuar ose material argjilor.

Materiali I thermuar duhet te plotesoje kerkesat e meposhtme :

a-Vleren e copetimit te aggregateve.

Coptezimi I aggregateve nuk duhet te kaloje 29% te firos.

b-Indeksi I plasticitetit

c-Kerkesat per ndarje (shkallezim)

Ne vendet me densitet te matur ne gjendje te thate te shtreses se ngjeshur , vlera minimale duhet te jete 98 % e vleres se proktorit te modifikuar.

6.PROFILIM ME STABILIZANT

Ne kete ze eshte parashikuar pastrimi i siperfaqes ekzistuse,shtrimi dhe nivelimi me grejder i shtreses se stabilizantit 10 cm vecanrishte ne rruget ekzistuse te cilave ju jane hequr shtresat asfaltike .Stabilizanti perbehet me material te thyer guri sipas stadarteve te miratuar.Matja eshte ne m2.

7.SHTRESE BINDERI 5 CM

Ne kete ze eshte parashikuar pastrimi i siperfaqes qe zgjerohet , sperkatja me emulsion bituminoz nga 0.8 – 1.2 liter/m² , si dhe prodhimin ose blerjen , transportin dhe shtrimin e binderit me makineri (rul) . Shtresa e binderit do te jete 6 cm mbas ngjeshjes . Prodhimi i binderit do te behet me material te thyer guri sipas stadarteve te miratuar.Matja eshte ne m².

8.SHTRESE ASFALTO – BETONI t=3cm

Ne kete shtrese eshte parashikuar sperkatja e te gjithe siperfaqes ekzistuse dhe zgjerimit me bitum 0.51 litra /m² , prodhimi ose blerja , transporti , shtrimi i asfaltit me makineri (rul).Shtresa do te jete 3 cm.

Asfalto betoni qe do te perdoret duhet te prodhohet nga materiali i thyer guri 0 – 10 mm , sipas stadarteve te miratuar.

Toleranca ne ndertim : Kontrolli do te behet cdo 25 metra dhe do te jete

Gabim ne gjeresi 2 cm

Gabim ne lartesi 1 cm

Ne kete ze pune eshte parashikuar edhe ngjeshja me rul sipas K.T. Z.

9.Bankinat

Bankinat do te ndertohen ne ted y anet e rruges me gjersi 50 cm e pjerresi 8% do te ndertohet sic eshte parashikuar ne projekt sipas K.T.Z.Stabilizanti do te ngjishet drejt asfaltit per ruajtjen e tijme perresi drejt kanaleve .
Matja eshte me m² ,

B. PUNIME KANALIZIMI

1. GERMIM DHEU ME MAKINERI.

Germimi i dheut eshte parashikuar per hapjen e kanalit dhe shkarkimin ne mjet te dheut sipas dimezoneve te dhena ne projekt , te largohen me auto,Pervec nje pjese te vogel qe do te perdoret per mbushje. Matja ne m³.

2. TRANSPORT I DHEUT DHE MBETURINAVE

Ne kete ze pune parashikohen largimi i dherave dhe mbeturinave qe do te dalin nga germimimet qe do te dalin i kasonetes dhe kanalit ne distancen 5 km.

PROJEKTUESI

Ing.Haxhi ABDULLAI

